



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 170, datë 29.09.2023

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË “PRICEWATERHOUSECOOPERS ASSURANCE
SERVICES” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE TË SHAFP DHE SIK “SIGAL-LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.,
SI DHE TË FONDEVE QË ADMINISTROHEN PREJ SAJ, PËR VITIN FINANCIAR QË
MBYLLET MË 31.12.2023.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë “PricewaterhouseCoopers Assurance Services” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “Sigal-Life Uniqa Group Austria” sh.a., si dhe të fondeve që administrohen prej saj, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**